



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:181516
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05755746

AA.nr.462/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit Z.D., nga fshati B.- O., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N. D., kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencia për Zvillimin e Bujqësisë (AZHB) me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2200/20, të datës 05.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit Z.D., e datës 15.06.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2200/20, të datës 05.04.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar ka refuzuar si të pabazuar, kërkesëpadinë e paditësit Z.D. nga Komuna e O. për anulimin e vendimit të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë i datës ... nr. .

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën, të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë duke miratuar padinë e paditëses Z.D., dhe të Anulon vendimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të nxjerrë aktgjykim me të cilin detyrohet Ministria e Bujqësisë të nxjerrë një vendim të ri dhe të bëjë pagesat e drejtpërdrejta në bujqësi për llogari të paditësit, ose shfuqizoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen të kthejë në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin me Nr...., i datës ..., ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit të datës 04.11.2020.

Paditësi, i pa kënaqur me këtë vendim ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kundër të paditurit MBPZHR në Prishtinë, duke pretenduar se vendimi i tij është jo ligjor. Gjykata e shkallës së parë, për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor, më datë 05.04.2023, në prani të paditësit dhe të autorizuarit të tij dhe në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, me arsyetim ndër të tjera se: Me vendimin Nr.... të datës ... të Komisionit të Ankesave për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2020 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit për pagesa direkte në bujqësi me arsyetimin se fermeri nuk ka qenë i qasshëm në datat 09, 10, 15, 17 dhe 21 shtator 2020 për të verifikuar gjendje në terren lidhur me aplikacionin e tij për 2.82 ha grurë, 1.16 ha misër, 1,26 ha elb dhe 5 dosa për riprodhim.

Në arsyetimin e vendimit të organit të paditur theksohet se fermeri nuk ka qenë i qasshëm në datat 09, 10, 15, 17 dhe 21 shtator 2020 për të verifikuar gjendje në terren lidhur me aplikacionin e tij për 2.82 ha grurë, 1.16 ha misër, 1,26 ha elb dhe 5 dosa për riprodhim.

Udhëzimi Administrativ 03/2020 për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2020, ka paraparë kritere të qarta për mënyrën e përfitimit në financim të projekteve kurse sipas të njëjtit Udhëzim kontrolli në terren është ligjërish i domosdoshëm për të verifikuar të dhënat e dorëzuara me gjendjen reale në terren të përfituesit të mbështetjes financiare konform Udhëzimi Administrativ.

Siç është theksuar edhe në arsyetimin e vendimit të kontestuar me padi, organi I paditur ka dëshmuar se ka bërë disa herë përpjekje për të realizuar kontroll në terren (fermeri nuk ka qenë i qasshëm në datat 09, 10, 15, 17 dhe 21 shtator 2020 për të verifikuar gjendje në terren lidhur me aplikacionin e tij për 2.82 ha grurë, 1.16 ha misër, 1,26 ha elb dhe 5 dosa për riprodhim sipas kërkesave të Udhëzimi Administrativ por si pasojë e mungesës së kontaktit me përfituesin e mbështetjes financiare ky kontroll nuk është realizuar.

Nga e gjithë kjo, gjykata vlerëson se vendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike si dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka vendosur lidhur me ankesën e paditësit.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë e vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm pasi që i njëjti është i bazuar në prova dhe ligj, në tërësi e aprovon, se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë sipas kompetencës si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, në mënyrë të drejtë ka shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e Vendimit të paditurës, të atakuar me padi, i cili vendim i ka të përmbledhura argumentet në të cilat është bazuar në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar, e të cilat Gjykata e Apelit, njëjtë si Gjykata e shkallës së parë i miraton si të drejta dhe ligjore.

Nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit në ankesë se aktvendimi i shkallës së parë është i pa qartë dhe kontradiktor duke pretenduar se e njëjta nuk i ka shqyrtuar mirë shkresat e lëndës dhe se nuk e ka shqyrtuar fare dokumentacionin e paditësit, Gjykata Apelit vlerëson se një pretendim i tillë është në tërësi i pa bazuar. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim të drejtë të së drejtës materiale. Nga shkresat e lëndës e sidomos nga procesverbali i kontrollit për pagesa direkte të datës 21.09.2020 vërtetohet se inspektorët për të verifikuar gjendje në terren lidhur me aplikacionin e tij për 2.82 ha grurë, 1.16 ha misër, 1,26 ha elb dhe 5 dosa për riprodhim sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ, kanë qenë në shtëpinë e paditësit të njëjtin nuk e kanë gjetur në shtëpi, po ashtu paditësin e kanë thirr në telefon në datat 09, 10, 15, 17 dhe me datë 21.09.2020 i njëjti nuk është lajmruar në telefon asnjëherë, dhe si pasojë e mungesës së kontaktit me përfituesin e mbështetjes financiare ky kontroll nuk është realizuar. Andaj duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 03/2020 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2020, kontrolli në terren është ligjrisht i domosdoshëm për të verifikuar të dhënat e dorëzuara me gjendjen reale në terren, neni 45 paragrafi 6 pika 6.2 i Udhëzimit Administrativ 03/2020 për Pagesat Direkte përcakton se: *“Aplikuesi përjashtohet nga programet përkrahëse për tri (3) vite (2020, 2021 dhe 2022) në bazë të vendimit të Agjencisë për shkeljet si ne vijim: 6.2. e ka penguar kontrollin zyrtar”*. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat paditësi i ka penguar inspektorët për kontroll në teren për faktin se i njëjti nuk është lajmruar asnjëherë në telefon dhe të njëjtin nuk e kanë gjetur në shtëpinë e tij. Andaj dhe aplikacioni me të drejtë është refuzuar dhe është sanksionuar paditësi me përjashtim të përkrahjes për tri vite.

Pretendimet ankimore të paditësit të theksuara si më lartë, se gjendja faktike nuk është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, po ashtu nuk është zbatuar drejtë e drejta materiale, se e njëjta ka prova të mjaftueshme, andaj gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësim të gabuar të provave etj. Kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore, dhe i refuzon si të pa qëndrueshme apo me ndikim për tu ndryshuar çështja dhe për të vendosur në mënyrë tjetër nga ajo e vendosur në organin administrativ përfundimtar dhe në Gjykatën e shkallës së parë, sepse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë në bazë të provave në shkresa të lëndës e po ashtu ligji material është aplikuar në mënyrë të drejtë.

Kolegji duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat materiale dhe procedurale me rastin e refuzimit të kërkesë padisë së paditësit dhe vërtetimit të vendimit të organit administrativ përfundimtar në procedurë administrative dhe pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi i shkallës së parë nuk vihet në dyshim, ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimit vërtetohet si i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj.

Andaj nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit, 49 të LKA-së, dhe neni 200 i LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
AA.nr.462/2023, me datë 21.05.2024

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi